

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS TË PËRGJITHSHME • ДРЕЈТОРИЈА ЗА ОПШТИНСКИ РАБОТ • ДИРЕКЦИЈА ЗА ОПШТИНСКИ РАБОТ		
Çalësi / Изазин / No. 01 / 10 / 2021		
Nr. Orgj. / Org. jed. / 01	Nr. Prot. / Br. Prot. / 86	Nr. Kështjese / Br. Strana. / 38
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 86  
Datë: 30.09.2021

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, nenit 40 paragrafi 40.2 pika (b) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), Ligji Nr.08/L-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.07/L-041 Ligji mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nenit 25, paragrafit 2 pikës 2.2 së Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën **30.09.2021**, miraton:

## V E N D I M PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2022-2024

### I

Me këtë vendim miratohet në Projektbuxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2022 dhe atë në shumë prej 33.933,868.00 dhe atë:

Paga dhe medijtje	-- 15,960,525.00
Mallra dhe shërbime	---- 5,529,067.00
Shpenzimet komunale	----- 725,686.00
Subvencione dhe transfere	----- 963,776.00
Shpenzimet kapitale	- 10,754,814.00

### II

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2022-2024 përbëhet prej këtyre njërive shpenzuese:

- Zyra e Kryetarit;
- Zyra e Kuvendit të Komunës;
- Zyra e Personelit;
- Zyra e Prokurimit;
- Zyra e Komuniteteve;
- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme;
- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë;
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit;

- Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
- Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenia Sociale;
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Drejtoria e Arsimit.

### III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projektbuxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2022-2024.

### IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

### V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

  
\_\_\_\_\_  
**Kristina Gashi Bytyçi**

REPUBLIC OF KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT		
REKORDI I DOKUMENTIT • REKORDI I DOKUMENTIT • REKORDI I DOKUMENTIT NO. Dokumenti: 011 / 10.09.2021		
Nr. Org. / Org. Jed. 011	Nr. Prot. / Br. Prot. 87	Nr. Fajllave / Br. Strana. 11
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 87  
 Datë: 30.09.2021

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, nenit 40 paragrafi 40.2 pika (i) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) nenit 11 të Ligjit Nr.04/L-071 dhe nenit 25, paragrafit 2 pika 2.8 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën **30.09.2021**, miraton:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E LISTËS REZERVË PËR ZONAT E QARKULLIMIT**  
**PUBLIK TË KOMUNËS SË FERIZAJT.**

**I**

Me këtë vendim APROVOHET: Propozimi Kryetarit të Komunës së Ferizajt 01.nr.1538/21 për Caktimin e emrave të Listës Rezervë për zonat e qarkullimit publik të Komunës së Ferizajt.

**II**

Lista e plotësuar me emërtime nga lista e mëparshme dhe me propozime të rinjë bëhet me kërkesë të qytetarëve, emërtime këto të cilat hyjnë në kategorinë - listë rezervë. Emrat rezervë në listë janë të përputhura me kriteret e emërimit të përcaktuara me ligj me qëllim për përdorim në të ardhmen.

**III**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista rezervë për zonat e qarkullimit publik të Komunës së Ferizajt.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.

**V**

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit të njoftojë Agjensionin kadastral.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

  
 Kristina Gashi Bytyci

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • URBANA ADMINISTRACIONI DSOBLJA		
Datale: Ndalim Date: Dima 01/10/2021		
Nr. Orgu Org. jed. 01	Nr. Proci Pr. Prost. 88	Nr. Faqene Nr. Strana 01
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 88  
 Datë: 30.09.2021

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, nenit 40 paragrafi 40.2 pika (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), neni 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe nenit 25, paragrafit 2 pikës 2.3 së Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën **30.09.2021**, miraton:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE NË PRONËN E PALUAJTSHME**  
**PËR VITIN 2022**

**I**

Me këtë vendim caktohen normat tatimore në pronën e paluajtshme për vitin 2022

**II**

- Për njësitë bujqësore të parcelave----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë bujqësore të objekteve----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë pyjore të parcelave----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë rezidenciale të parcelave----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë rezidenciale të objekteve----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë komerciale të parcelave----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë komerciale të objekteve----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë industriale të parcelave----- (0.15% norma tatimore)
- Për njësitë industriale të objekteve----- (0.15% norma tatimore)


**III**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

  
 Kristina Grashi-Bytyçi